



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 45, datë 14.04.2021

**PËR
MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE
FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN MARS 2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB-së Nr. 1, datë 28.01.2021 "Për miratimin e kriterëve, për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike, si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”, VKB-së Nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 91 familje me një fond prej 303.460 (treqind e tremijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë.

2. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për 12 familje me një fond prej 31.300 (tridhjet e njëmijë e treqind) lekë. Ky fond do të jetë nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike.

3. Miratimin e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike për këtë muaj gjithsej 4 familje nga fondi i Bashkisë si më poshtë:

a. Njësia Administrative Nr. 3

- Desdemona Hameti Mos plotësim dokumentacioni.

b. Njësia Administrative Nr. 4

- Ylli Avziu Kalon në skemën e NE
- Marte Lleshi Kalon në skemën e NE



c. Njësia Administrative Sukth

- Zef Vatha Mos plotësim dokumentacioni

4. Miratimin e futjes në skemën e ndihmës ekonomike për muajin Mars 2021 të 3 (tre) familjeve, të cilat janë në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës si më poshtë:

a. Njësia Administrative Nr. 3

- Megi Doka Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3000 lekë
- Dhimiter Soku Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë

b. Njësia Administrative Sukth

- Saimir Cani Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3000 lekë

5. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike me fond nga Bashkia 0 familje.

6. Hyrje në skemën e ndihmës ekonomike deri në 6% e fondit të kushtëzuar 3 familje.

7. Dalje nga skema e ndihmës ekonomike deri në 6% e fondit të kushtëzuar 0 familje.

8. Lista e 12 familjeve për muajin Mars 2021, që do të jenë përfitues të ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar është si më poshtë :

- | | |
|-----------------------|---|
| • Bujar Buna | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë |
| • Flutura Herriu | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë |
| • Vjollca Jora | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2700 lekë |
| • Vera Aliu | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë |
| • Xhemile Baroti | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë |
| • Teuta Drizati | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3060 lekë |
| • Aferdita Hysenllari | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë |
| • Miranda Kaja | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2160 lekë |
| • Shpresa Korra | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë |
| • Gjinofova Danaj | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë |
| • Mimoza Kodra | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë |
| • Përparim Mejdani | Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 4880 lekë |

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Durrës.

10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 14.04.2021



BASHKIA DURRES
16/4/21 Nr. 464/3 PROT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 271/prot.



Durrës, më 16.04.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 45 datë 14.04.2021 “Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri në 6% dhe fondi nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Mars 2021”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ROLAND NASTO

